



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Zyra Ekzekutive – Komisioni i Pavarur i Mediave

RAPORT MONITORIMI

“MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE TË OSHMA-VE”

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS

Periodha e monitorimit shkurt - mars 2020

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission,
Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 124 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština-Pristina/Kosovë-Kosovo,
Tel: (+383) (0) 38 245 031, Fax: (+383) (0) 38 245 034, E-mail: info@kpm-ks.org; www.kpm-ks.org;

Përmbajtja

Përkufizimet	2
Hyrje	3
I. BAZA LIGJORE	4
II. METODOLOGJIA	5
III. PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE	8
RTK1	8
TV 21	13
RTK2	19
KTV	25
TV DUKAGJINI	30
KLAN KOSOVA	35
TE 7	41
IV MBULIMI I SITUATËS PANDEMIKE NË EDICIONET E LAJMEVE QENDRORE	47
V PËRFUNDIM	50
VI. REKOMANDIM	53

Përkufizimet

- KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.
- DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizës i KPM-së.
- OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel – nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
- OSH – Operatori i shpërndarjes – personi juridik i cili shpërndan shërbime mediale audio dhe audio-vizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV, OTT, satelitor dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv tokësor.

Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuele, përfshirë këtu edhe aspektet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim.

Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut.

E drejta e lirisë së mendimit dhe të shprehjes, përfshirë lirinë e mbajtjes së mendimit pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, pranuar dhe shpërndarë informacion dhe ide përmes mediave është e drejtë e garantuar edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara si dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, që krahas zhvillimeve teknologjike sot janë të qasshme për publikun përmes kanaleve të shumta të komunikimit, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është e nevojshme të kemi një pasqyrë të vlerësimit të lajmeve që i plasohen publikut nga ofruesit e shërbimeve mediale audiovizuele në Kosovë.

Lidhur me këtë, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës së KPM-së ka realizuar monitorimin e lajmeve qendrore të ofruara nga të licencuarit e saj gjatë muajit shkurt dhe mars të vitit 2020, me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve që ofrohen për qytetarët e Kosovës.

I. BAZA LIGJORE

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përkatësisht nenit 9, përcaktohet se:

“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja duhet të jetë në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare të transmetimit dhe të të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-se e në veçanti me Direktivën e Komisionit Evropian AVMS duke respektuar plotësisht demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes”.

“Politika e transmetimit e përcaktuar nga KPM-ja, duhet të reagojë në të drejtën e publikut për të ditur dhe për t’u njoftuar përmes promovimit të programeve të sakta dhe informative”.

Sipas Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës të KPM-së, respektivisht nenit 6, përcaktohet se:

Paragrafi 1 *“OSHM-të duhet të raportojnë lajme me saktësi dhe t’i paraqesin ato në mënyrë të paanshme. Ata nuk duhet të transmetojnë material për të cilin e dinë ose duhet të dinë se është i pavërtetë ose mashtrues”.*

Paragrafi 2 *“OSHM-të duhet të sigurojnë një mbulim të balancuar të çështjeve me interes publik dhe çështjeve të kundërtshënive politike dhe të sigurojnë një paraqitje pluralistike të pikëpamjeve, pa asnjë privilegj për ndonjë parti politike, këndvështrim politik apo ndonjë grup ose individ”.*

Paragrafi 4 *“Përderisa OSHM-të janë të lirë për të shprehur opinionet e tyre, ata duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet lajmit dhe opinionit. Lajmi është informacion i përbërë nga faktet dhe të dhënat, ndërsa opinionit mbart mendimet, idetë, besimet, supozimet, komentet apo gjykimet vlerësuese”.*

Paragrafi 7 *“OSHM-të duhet të ofrojnë prezantim të perspektivave të ndryshme në mënyrë korrekte dhe të drejtë. Në qoftë se njëra palë refuzon që të ofrojë pikëpamjen e saj, publiku duhet të informohet për këtë refuzim”.*

Paragrafi 8 *“OSHM-të duhet të bazohen në burime të identifikueshme të informacionit dhe duhet të jenë të përkushtuar për të mbrojtur identitetin e atyre që japin informacion në besim, pa marrë parasysh se a kërkohet kjo paraprakisht apo jo”.*

II. METODOLOGJIA

Me qëllim të vlerësimit dhe analizimit të përmbajtjeve të ofruara përmes edicioneve informative të lajmeve qendrore është përdorur metodologjia e kombinuar, kuantitative dhe kualitative.

Fillimisht janë grumbulluar të dhënat statistikore nga subjektet e hulumtimit dhe më pas ato janë kategorizuar dhe përpunuar për arritjen e rezultateve të sakta dhe prezantimin vizual të rezultateve. Mjetet e punës që janë shfrytëzuar për këtë monitorim janë: sistemi i monitorimit, i cili ka mundësuar qasje dhe ruajtje të përmbajtjes programore të subjekteve të këtij monitorimi, për matje, analizim edhe vlerësim.

Vlerësimi i përmbajtjeve të edicioneve qendrore të lajmeve është bërë nga zyrtarët monitorues të DMA-së, për periudhën kohore dy (2) mujore, duke përfshirë muajin shkurt dhe mars të vitit 2020.

Mostra e monitorimit përfshinë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tri (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor lokal (TV DUKAGJINI); dhe
- Tri (3) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, KLAN KOSOVA dhe TE7).

Për nxjerrjen e të dhënave sa i përket hapësirës së dhënë për kategoritë e përcaktuara është përdorur metoda kuantitative duke matur me sekonda kohën e dhënë në kronika/tema.

Përmbajtja e monitoruar është ndarë sipas kategorive/temave dhe nënkategorive në vijim:

1. Politikë, që ka përfshirë veprimtarinë e:

Presidentit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Presidenti si protagonist (intervistë, prononcim/deklaratë e drejtpërdrejtë apo përmes komunikatave për media/rrjete sociale, vizita, takime etj..).

Presidencës - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të Zyrës së Presidentit, p.sh. këshilltarët, etj.

Kryeministrit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryeministri si protagonist (intervistë, prononcim/deklaratë e drejtpërdrejtë apo përmes komunikatave për media/rrjete sociale, vizita, takime, etj..).

Qeverisë - kronika që përfshinë aktivitetet e zhvilluara në kuadër të qeverisë në përgjithësi, p.sh. zëvendësit apo pjesëtarët e kabinetit si p.sh. këshilltarët/ apo agjenci në kuadër të Zyrës së KM-së,

ministritë, duke përfshirë aktivitetet në të cilën janë të përfshirë Ministri/zv.Ministri, apo pjesëtarë të kabinetit të ministrisë përkatëse

Kryetari i Kuvendit - aktiviteti/kronika ku është i përfshirë Kryetari i Kuvendit si protagonist;

Kuvendit të Kosovës - kronika që përfshinë aktivitetet (mbledhjet/takimet/vizitat etj.) e anëtarëve të Kryesisë, anëtarëve të komisioneve të Kuvendit, kronika nga seancat e Kuvendit, etj.

Subjekteve politike - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e subjektit të caktuar politik, p.sh. konferencat për media, aktivitetet partiake, deklaratatë të drejtpërdrejta apo përmes rrjeteve sociale, intervista, etj.

Tjera - aktiviteti/kronika në të cilën përfshihen aktivitetet e institucioneve/organizatave tjera të pavarura, organizata ndërkombëtare, ambasada të Kosovës apo të vendeve të huaja, etj. Në çështjet që ndërlidhen me zhvillimet politike në vend.

2. Ekonomi/tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik:

Çështje të përgjithshme ekonomike - lidhur me të ardhurat në nivel nacional, konsumi dhe investimet, inflacioni, GDP, çmimet, kursimet, rritja e tregut, papunësia, konkurrenca, etj...

Bujqësi - tema lidhur me bujqësi në përgjithësi.

Industri/prodhimtari - tema lidhur me industri/prodhimtari në përgjithësi.

Tjera - nënkategori të tjera të pa përfshira më sipër, që ndërlidhen me aspektin ekonomik.

3. Kategori të tjera të sferave të caktuara, ka përfshirë fusha si:

Drejtësia/Sundim i Ligjit - aktivitete/kronika që trajtojnë tema në fushën e drejtësisë, sundimin e ligjit në përgjithësi, respektimin e parimeve të epërsisë së ligjit, barazisë para ligjit, llogaridhënies ndaj ligjit, drejtësisë në zbatimin e ligjit, ndarjes së pushteteve, pjesëmarrjes në vendimmarrje, sigurisë juridike, etj...

Siguria - aktivitete/kronika që trajtojnë tema në fushën e sigurisë në përgjithësi (aktivitetet lidhur me mbrojtjen e territorit, qytetarëve kundër kërcënimeve për mirëqenien e tyre dhe për prosperitetin e komuniteteve të tyre (Ushtria, Policia, Zjarrfikësit, AKI dhe agjenci tjera të sigurisë), duke përfshirë zbatimin e ligjit, zjarrin, urgjencën mjekësore, ngjarjet që mund të rrezikojnë sigurinë e publikut të gjerë nga rreziqet e ndryshme, terrorizmi, dëmtimi ose dëmtimi i pronës, krimi i organizuar (përdorimi i narkotikëve, vjedhje, vrasje, etj..), komunikacion, fatkeqësitë natyrore ose të bëra nga njeriu.

Sociale - tema/kronika që trajtojnë tema shoqërore në përgjithësi.

Art/Kulturë/Edukim - tema/kronika që trajtojnë tema nga arti, kultura dhe arsimi.

Shëndetësi - tema/kronika që trajtojnë tema nga shëndetësia.

Tjera - nënkategori të tjera të pa përfshira në nënkategoritë më sipër.

4. Lajmet ndërkombëtare, janë ndarë në tri nënkategori:

Rajon - temat nga rajoni përfshirë: Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Bosnje Hercegovinën dhe Serbinë.

Evropë - kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në vendet evropiane.

Botë - kronika që trajtojnë tema rreth ngjarjeve në Botë (duke përjashtuar Evropën).

5. Sport:

Vendor - duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në vend.

Ndërkombëtar - duke përfshirë lajme dhe kronika rreth ngjarjeve sportive në arenën ndërkombëtare.

Ndërsa, metoda kualitative është përdorur për të vlerësuar nëse lajmet e transmetuara në kronika kanë qenë relevante (mbulim i ngjarjeve/temave të kohës), janë transmetuar me saktësi (përmbajtja bazuar në informata dhe fakte të verifikuara saktë), nëse është siguruar mbulim i balancuar i çështjeve me interes publik (dy ose më shumë palë të përfshira në temën/kronikën për çështje të caktuara) si dhe është bërë vlerësimi për mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimi nga gazetari/reporteri/mediumi, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve.

Sa i përket raportit gjinor, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sa i përket numrit të moderimit/udhëheqjes dhe editimit/redaktimit të lajmeve në bazë të gjinisë si dhe hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit sipas gjinisë. Raporti gjinor është matur edhe në prezantimin e tri kronikave të para të edicioneve qendrore.


III. PREZANTIMI I GJETJEVE NGA MONITORIMI I LAJMEVE QENDRORE

RTK1

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK1) të orës 19:30 për periudhën monitoruese 01 shkurt deri më 31 mars 2020, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

Periudha monitoruese: 01 - 29 shkurt 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK1 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 54.52%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 5.49%, kategori të tjera të sferave të caktuara 33.01%, lajme ndërkombëtare 6.98% dhe sport 0.00%.



(Grafikoni 1, RTK shkurt 2020)

Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 54.52%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 4.15%
- Presidenca 0.16%
- Kryeministri 7.73%
- Qeveria 15.24%
- Kryetari i Kuvendit 3.23%
- Kuvendi 1.21%
- PDK 1.66%
- LDK 1.99%
- LVV 1.21%
- AAK 4.23%
- PSD 0.21%
- NISMA 0.36%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 13.14%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 5.49%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 2.57%
- Bujqësi 1.56%
- Industri-prodhimtari 1.26 %
- Tjera 0.10%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 33.01%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 4.92%
- Siguri 1.56%
- Sociale 8.84%
- Art/Kulturë/Edukim 12.58%
- Shëndetësi 3.18%

- Tjera 1.93%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 6.98%, prej tyre:

- Rajon 1.57% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut.
- Evropë 0.73% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Turqi, Gjermani, Itali, Britani e Madhe dhe Norvegji.
- Botë 4.68% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Rusi, Hong Kong, Tajlandë, Kinë, Japoni, Kore të Jugut dhe Egjipt.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, gjatë muajit shkurt nuk janë transmetuar fare kronika sporti.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 46.43% nga femrat kurse 53.57% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë tërësisht nga meshkujt.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme, gjatë muajit shkurt nuk janë transmetuar kronika sportive.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I: 39.29% (M) 60.71% (F)


Kronika II: 39.29% (M) 60.71% (F)

Kronika III: 39.29% (M) 60.71% (F)

Periudha monitoruese: 01 - 31 mars 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK1 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 36.14%, ekonomi dhe tema tjera që

ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 7.58%, kategori të tjera të sferave të caktuara 44.94%, lajme ndërkombëtare 11.10% dhe sport 0.24%.



(Grafikoni 2, RTK mars 2020)

Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 36.14%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 6.62%
- Presidenca 0.00%
- Kryeministri 3.73%
- Qeveria 7.83%
- Kryetari i Kuvendit 0.72%
- Kuvendi 4.21%
- PDK 2.59%
- LDK 3.73%
- LVV 0.70%
- AAK 1.31%
- PSD 0.03%
- NISMA 0.20%

- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 4.47%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 7.58%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 5.99%
- Bujqësi 0.82%
- Industri-prodhimtari 0.24%
- Tjera 0.53%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 44.94%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 2.61%
- Siguri 15.26%
- Sociale 4.13%
- Art/Kulturë/Edukim 6.62%
- Shëndetësi 14.38%
- Tjera 1.94%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 11.10%, prej tyre:

- Rajon 7.26% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 0.90% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Itali, Britani e Madhe, Turqi, Spanjë e Gjermani.
- Botë 2.94% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: SHBA, Kinë, Izrael, Kore e Jugut.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 0.24% dhe atë vetëm tema nga sporti vendor.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 25.81% nga femrat, kurse 74.19% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 90.32% nga meshkujt kurse 9.68% nga femrat.

Sa i përket hapësirës së sportit dedikuar në lajme (0.24% e totalit të lajmeve), e tërë hapësira i kushtohet sportit vendor për femra.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:


Kronika I:	32.26% (M)	67.74% (F)
Kronika II:	38.71% (M)	61.29% (F)
Kronika III:	51.61% (M)	48.39% (F)

TV 21

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të TV 21 të orës 18:30 për periudhën monitoruese 01 shkurt deri më 31 mars 2020, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

Periudha monitoruese: 01 - 29 shkurt 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që TV 21 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 55.16%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 2.48%, kategori të tjera të sferave të caktuara 20.55%, lajme ndërkombëtare 17.81% dhe sport 4.00%.



(Grafikoni 3, TV21 shkurt 2020)

Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 55.16%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.44%
- Presidenca 0.03%
- Kryeministri 29.96%
- Qeveria 5.76%
- Kryetari Kuvendit 2.16%
- Kuvendi 0.90%
- PDK 1.53%
- LDK 1.40%
- LVV 0.45%
- AAK 1.50%
- PSD 0.22%
- NISMA 0.0%

- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 9.81%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 2.48%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 2.14%
- Bujqësi 0.00%
- Industri-prodhimtari 0.34%
- Tjera 0%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 20.55%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 2.03%
- Siguri 0%
- Sociale 5.70%
- Art/Kulturë/Edukim 9.33%
- Shëndetësi 1.45%
- Tjera 2.04%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 17.81%, prej tyre:

- Rajon 4.82% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 4.81% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Austri, Britani e Madhe, Turqi, Francë.
- Botë 8.18% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Arabia Saudite, SHBA, Iran, Armeni, Siri, Kinë, Australi.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 4.0%, tema rreth sportit vendor 3.03% dhe sporti ndërkombëtarë 0.97%.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 68.97% nga femrat kurse 31.03% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 89.66% nga femrat, kurse 10.34% nga meshkujt. Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (4% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 15.48%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 84.52%.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:


Kronika I: 13.79% (M) 86.21% (F)

Kronika II: 10.34% (M) 89.66% (F)

Kronika III: 20.69% (M) 79.31% (F)

Periudha monitoruese: 01 -31 mars 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që TV 21 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 31.38%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 4.14%, kategori të tjera të sferave të caktuara 35.60%, lajme ndërkombëtare 24.84% dhe sport 4.04%.



(Grafikoni 4, RTV21 mars 2020)

Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 31.38%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 4.74%
- Presidenca 0.05%
- Kryeministri 3.58%
- Qeveria 4.65%
- Kryetari Kuvendit 0.13%
- Kuvendi 4.37%
- PDK 2.23%
- LDK 1.87%
- LVV 0.40%
- AAK 0.79%
- PSD 0.00%
- NISMA 0.13%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 8.44%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 4.14%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 3.13%
- Bujqësi 0.47%
- Industri-prodhimtari 0.00%
- Tjera 0.54%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 35.60%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 1.62%
- Siguri 6.43%
- Sociale 6.70%
- Art/Kulturë/Edukim 6.12%
- Shëndetësi 9.94%
- Tjera 4.79%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 24.84%, prej tyre:

- Rajon 8.51% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 5.56% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Austri, Britani e Madhe, Turqi, Francë.
- Botë 10.77% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Arabia Saudite, SHBA, Iran, Armeni, Siri, Kinë, Australi.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sporti i është kushtuar hapësirë prej 4.04%, prej tyre sport vendor 1.74% kurse sport ndërkombëtar 2.30%.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 61.29% nga femrat kurse 38.71% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 100% nga femrat.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme (4.03% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 15.15%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 84.85%.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:

Kronika I: 45.16% (M) 54.84% (F)

Kronika II: 48.39% (M) 51.61% (F)


Kronika III: 35.48% (M) 64.52% (F)

RTK2

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të Radio Televizionit të Kosovës (RTK2) të orës 19:00 për periudhën monitoruese 01 shkurt deri më 31 mars 2020, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

Periudha monitoruese: 01 - 29 shkurt 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK2 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 37.33%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 3.22%, kategori të tjera të sferave të caktuara 31.61%, lajme ndërkombëtare 21.29% dhe sport 6.55%.



(Grafikoni 5, RTK2 shkurt 2020)

Politikë:

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 37.33%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.81%
- Presidenca 0.17 %
- Kryeministri 4.49%
- Qeveria 4.66%
- Kryetari i Kuvendit 1.80%
- Kuvendi 1.02%
- PDK 0.32%
- LDK 0.87%
- VV 0.71%
- AAK 1.24%
- PSD 0.0%
- NISMA 0.49%
- Tjera 19.75% - Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 3.22%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 0.95%
- Bujqësi 2.02%
- Industri/prodhimtari 0.18%
- Tjera 0.07%

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 31.61%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 4.59%
- Siguri 1.22%
- Sociale 4.84%
- Art/Kulturë/Edukim 6.10%
- Shëndetësi 3.70%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 11.16%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 21.29%, prej tyre:

- Rajon 4.49% që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Serbi, Maqedoni e Veriut, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë.
- Evropë 4.18% që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Britani të Madhe, Francë, Rumani, Rusi, Turqi, Ukrainë, Greqi, Austri.
- Botë 12.62% që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Kinë, Irak, Tanzani, Keni, Arabia Saudite, Japoni, Tajlandë, Afganistan, Indi dhe Egjipt.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 6.56% prej tyre 2.45% sport vendor dhe 4.11% sport ndërkombëtar.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 79.31% nga femrat kurse 20.69% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 72.41% nga femrat dhe 27.59% nga meshkujt.

Sa i përket hapësirës së sportit, dedikuar në lajme 6.55% e totalit të lajmeve, temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 10.95%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 89.05%.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:


Kronika I: 31.03% (M) 68.97% (F)

Kronika II: 34.48% (M) 65.52% (F)

Kronika III: 34.48% (M) 65.52% (F)

Periudha monitoruese: 01 -31 mars 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që RTK2 i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 26.23 %, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 4.27 %, kategori të tjera të sferave të caktuara 36.61 %, lajme ndërkombëtare 26.27 % dhe sport 6.62 %.



(Grafikoni 6, RTK2 mars 2020)

Politikë:

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 26.23%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 2.69%
- Presidenca 0.09%
- Kryeministri 2.94%
- Qeveria 3.56%
- Kryetari i Kuvendit 0.37%
- Kuvendi 1.93%
- PDK 0.51%
- LDK 1.23%
- VV 0.21%
- AAK 0.83%
- PSD 0.0%
- NISMA 0.07%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 11.80%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 4.27%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 1.77%
- Bujqësi 1.61%
- Industri/prodhimtari 0.0%
- Tjera 0.89%

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 36.61%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 1.89%
- Siguri 4.83%
- Sociale 4.29%
- Art/Kulturë/Edukim 2.35%

- Shëndetësi 11.23%
- Tjera 12.02%

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 26.27%, prej tyre:

- Rajon 10.62% , që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Serbi, Maqedoni e Veriut, Shqipëri, Mal të Zi, Bosnje dhe Hercegovinë.
- Evropë 9.28%, që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Britani e Madhe, Itali, Rusi, Spanjë, Gjermani, Turqi, Rumani, Hungari, Austri, Zvicër, Belgjikë, Sllovakia, Çekia, Greqi, Danimarkë dhe Poloni.
- Botë 6.37%, që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Jemen, Koreja Jugore, Egjipt, Australia, Arabia Saudite, Siri, Japoni, Libi, Uganda, Irak, Izrael, Brazil, Filipine, Ekuador, Kolumbia, Guineja, Kanada dhe Venezuela.

Sport

Në kuadër të edicioneve të lajmeve, sportit i është kushtuar hapësirë prej 6.62% prej tyre 2.48% sport vendor dhe 4.14% sport ndërkombëtar.

Raporti gjinor në redaktim dhe prezantim të lajmeve, në tri kronikat e para si dhe në hapësirën e sportit

Në periudhën e monitoruar, prezantimi i lajmeve është bërë 65.52% nga femrat kurse 34.48% nga meshkujt. Ndërkaq, redaktimi i lajmeve është bërë 72.41% nga femrat dhe 27.59% nga meshkujt.

Sa i përket hapësirës së sportit në lajme (6.62% e totalit të lajmeve), temave rreth sportit për femra i është kushtuar hapësirë prej 10.95%, ndërsa për meshkuj hapësirë prej 89.05%.

Ndërsa, raporti gjinor sipas prezantimit në tri (3) kronikat e para të lajmeve është si në vijim:


Kronika I:	48.28% (M)	51.72% (F)
Kronika II:	55.17% (M)	44.83% (F)
Kronika III:	37.93% (M)	62.07% (F)

KTV

Në bazë të monitorimit të lajmeve qendrore të KTV-së të orës 19:30 për periudhën monitoruese 01 shkurt deri më 31 mars 2020, në përgjithësi lajmet kanë qenë relevante dhe kanë mbuluar ngjarjet kryesore të ditës dhe kryesisht ngjarjet politike që kanë të bëjnë me vendin. Raportimet janë bazuar në burime të sakta të informacionit dhe kanë qenë të balancuara duke përfshirë dy apo më shumë palë dhe/apo burime të përfshira në ngjarjen e raportuar. Ndërkaq, sa i përket konotacionit gjatë raportimit, prezantimi në përgjithësi ka qenë neutral.

Periudha monitoruese: 01 - 29 shkurt 2020

Sa i përket hapësirës së dhënë në lajme, në bazë të monitorimit rezulton se kjo është hapësira që KTV i ka dedikuar për kategoritë e mëposhtme: politikë 42.59%, ekonomi dhe tema tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik 2.49%, kategori të tjera të sferave të caktuara 36.27%, lajme ndërkombëtare 17.19% dhe sport 1.46%.



(Grafikoni 7, KTV shkurt 2020)

Politikë

Hapësira e përgjithshme në lajmet qendrore në periudhën monitoruese e dedikuar për këtë kategori ka qenë në sasi prej 42.59%, prej tyre nënkategorive në vijim i është dhënë kjo hapësirë:

- Presidenti 1.98%
- Presidenca 0.0%
- Kryeministri 6.44%
- Qeveria 13.84%
- Kryetari i Kuvendit 1.62%
- Kuvendi 2.72%
- PDK 2.31%
- LDK 2.01%
- LVV 1.18%
- AAK 1.43%
- PSD 0.00%
- NISMA 0.24%
- Tema tjera lidhur me situatën politike dhe aktuale në vend 8.82%.

Ekonomi / tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik

Sa i përket ekonomisë dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, në edicionet e lajmeve u është dhënë hapësirë prej 2.49%, prej tyre:

- Çështje të përgjithshme ekonomike 0.00%
- Bujqësi 0.29%
- Industri-prodhimtari 0.87%
- Tjera 1.33%.

Kategori të tjera të sferave të caktuara

Temave që kanë të bëjnë me sfera të caktuara shoqërore u është dhënë hapësirë prej 36.27%, prej tyre:

- Drejtësi/Sundim i Ligjit 9.92%
- Siguri 2.18%
- Sociale 8.60%
- Art/Kulturë/Edukim 5.95%
- Shëndetësi 3.04%

- Tjera 6.58%.

Lajme ndërkombëtare

Sa i përket lajmeve ndërkombëtare, në edicionet e lajmeve i është kushtuar hapësirë prej 17.19%, prej tyre:

- Rajon 1.55% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike, në: Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Serbi e Mal të Zi.
- Evropë 3.98% - që kanë përfshirë tema rreth ngjarjeve, kryesisht politike por edhe tjera, në: Gjermani, Britani e Madhe, Turqi, Greqi, Francë, Itali, Zvicër.
